



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 19.5.2015, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Adem Salihaj, Shaip Muja, Salih Salihu, Murat Hoxha, Haxhi Shala, Lahi Brahimaj.

Munguan : Përfaqësuesi nga lista serbe në këtë komision, ende nuk ka prezantuar.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 13.5.2015,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve për cilësinë e grurit të importuar,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, dhe u sugjeruan disa nënpika për pikën e fundit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.5.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar. **Murat Hoxha** kishte vërejtje në jokuptimësinë e deklaratës së tij të shkruar, ndërkaq kryetari sugjeroi të përmirësohet bashkërisht me stafin.

3. Rekomandimet rreth cilësisë së grurit të importuar

Kryetari përshëndeti anëtarët e komisionit dhe i ftoi që shkurtimisht të parashtrojnë mendimet nëse kanë, pastaj komisioni të miratoi rekomandimet. **Adem Salihaj** ishte i mendimit që rekomandimet për cilësinë e grurit të importuar janë të gatshme për votim, ngase deri tani komisioni dhe GP ato i ka analizuar, poashtu është shtuar edhe një rekomandim nga propozimi i

anëtarit Shaip Muja. Në rekomandimin 2 në fund propozoi të shtohet fjalia **dhe kjo databazë të jetë publike**. Anëtari tjetër i GP **Salih Salihu** gjithashtu ishte i mendimit të ngjashëm ndërkaq **Shaip Muja** ritheksoi se me rekomandime nuk është pajtuar deri tani për shkak se janë filozofike dhe konkluduese dhe nuk qartësojnë a është shkelur ligji dhe sa po respektohet ligji, njëkohësisht japi shpjegimet e tij rreth mospajtimit me disa rekomandime siç është përfshirja e databazës për disiplinim dhe për të mos pasur mundësi për interfejsa (ndërhyrje) të ndryshme dhe fjalës dogana për të përdorur në njëjës, gjithashtu potencoi se ai me votën e tij nuk dëshiron :

- të kontribuoi në caktimin e posteve sipas dëshirës së dikujt në qeveri,
- të qetë mjegull në faktin se a po ushqehemi me krunde apo miell,
- të kontribuoi në bllokadën e qeverisë për analizën e bërë rreth këtij problemi,
- të mbroj qeverinë për mosdhënie të llogarisë para kuvendit,
- të kontribuoi për mosdhënie të dorëheqjes nga kryeministri dhe ministri për bujqësi,
- të kontribuoi në sjelljen e kundërshtimit të rekomandimeve me ligjin në fuqi (kolizioni i rekomandimit 3 me rekomandimin 2 të tij),
- të krijoj mjegulli në vend se të ketë qartësi,
- të kontribuoi në futjen e AUV nën ombrellën e MB,
- të kontribuoi në joqartësinë e faktit pse na hyn një mall nga jashtë ma lirë etj dhe disa dilema tjera

Salih Salihu duke u përgjigjur theksoi se GP ka mbledhur të gjitha të dhënat rreth dyshimeve të shfaqura për grurin e importuar duke i bazuar këto dyshime në dokumentacionet e gjetura gjatë vizitave të kryera dhe ka vërtetuar se këto dyshime janë të bazuara (p.sh. mospërputhja e cifrave tregon dyshimin e bazuar), ndaj edhe sugjeroi të votohen dy dokumentet, ajo e GP dhe ajo e Shaip Mujës.

Haxhi Shala lavdëroi punën e GP në të cilin edhe vet ka mar pjesë disa herë dhe ku janë konstatuar mangësitë e shumta sidomos në mungesën e vëzhgimit institucional të grurit nga ana e AUV dhe IKB.

Lahi Brahimaj gjithashtu potencoi se gjatë punës në GP ku ka mar pjesë edhe ai jo rregullisht, ka pasur jo siguri sidomos gjatë evidentimeve se kush çka dhe sa ka mar, dmth nuk ka pasur rexhistrime në libra. **Salih Salihu** ndërhyri dhe konstatoi se megjithatë ka pasur jopërputhje në mes cifrave.

Murat Hoxha tha se përfundimi i kësaj pune është e lidhur ngusht me konstatime (të cilat rrjedhin nga vizitat në terren) dhe rekomandime (të cilat janë gjithëpërfshirëse), gjithashtu fillojnë dhe mbarojnë me Qeveri, ndaj poqes ne si komision do të fillonim me realizime, vazhdoi, do të duhej të identifikojmë burimin , i cili burim është mjaft i ndotur me shumë paqartësi. Rekomandimet sipas tij janë pasqyrë reale.

Kryetari Fikrim Damka hapi votimin për rekomandimet e GP të cilat u votuan me 6 vota për dhe dy abstenime, si vijon :

1.Qeveria të ndërmarrë veprimet e duhura ne ngritjen e përgjegjësisë se stafit udhëheqës të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUV) ne zbatimin e ligjit, në mënyrë që popullata e Kosovës të jetë e mbrojtur nga produktet ushqimore te dyshimta.

2.Te krijohet nje sistem i avansuar i databazes per regjistrimin e te gjitha kontrollimeve fotosanitare dhe veterinare te produkteve te importuara dhe atyre vendore.

3.Të ndryshohen politikat fiskale per grurin e importuar me qellim te mbrojtjes dhe stimulimit te prodhimit vendor te grurit. Te ndryshohet rregullorja e QRK nr. 19/2014 per caktimin e lartesisë se shterimeve dhe kontrolleve zyrtare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUV).

4.Qeveria të ketë një mbikëqyrje më serioze ndaj Doganës së Kosovës, në aspektin e zbatimit të ligjit dhe Kodit Doganor lidhur me taksat doganore për importuesit e grurit.

5.Të ndërmerren masa kontrolli dhe përgjegjësie ndaj përgjegjësve të Institutit Bujqësor të Kosovës në Pejë (IBK), për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë dhe atij profesional. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me menagjmentin e IBK-së të ndërmarrë veprimet e duhura për akreditimin e laboratorit të IBK-së.

6. Të kërkohej nga Administrata Tatimore e Kosovës një kontroll më i madh në çështjet e evazionit fiskal të importuesve të grurit në Kosovë.

7. Tre muaj pas aprovimit të këtij Raporti me Rekomandime, Qeveria t'i raportojë Kuvendit të Kosovës lidhur me hapat dhe veprimet e ndërmarra.

4...Të ndryshme

Në pikën të ndryshme u hapën temat në vijim :

Formimi i GP rreth ndotjes së mjedisit nga Feronikli dhe operatorët tjerë

Pasi që lidhur me këtë çështje diskutuan **Shaip Muja** i cili arsyetoi themelimin e GP për shkak të lëshimeve nga MMPH për mosmonitorim të ajrit, tokës dhe ujit dhe vazhdimin e kontaminimit nga Feronikli dhe nevojën për analiza të lartcekura dhe të gjakut, **Adem Salihaj** i cili potencoi mungesën e argumentimit si shkak të mungesës së mjeteve monitoruese në institucionet tona, **Lahi Brahimaj** i cili sugjeroi të kërkohej donacioni për analiza nga qeveria, ngase poqëse nuk ka gjallesa në lumenj e gjetiu, kjo është argument i mjaftushëm për ndotje përkatësisht helmime të gjallesave siç janë peshqit etj, **Salih Salihu** i cili arsyetoi formimin e GP i cili do të sugjeroi zgjidhjen e problemeve për shkak të mosmonitorimit të mjedisit, **Emilija Redzeqi** e cila tha se GP doemos duhet të formohet ngase asnjë hap nuk bëhet pa analiza, ndaj Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Themelohet Grupi Punues : Shaip Muja, kryesues, Lahi Brahimaj, Emilija Redzeqi dhe Salih Salihu anëtarë, i cili grup punues do të hulumtoi mundësinë e gjetjes së rrugdaljes nga gjendja e mosmonitorimit të mjedisit nga ana e MMPH nëpër ato rajone ku operojnë operatorët që ndotin mjedisin.

Problemet me kufijt e Kosovës

Rreth kësaj problematike diskutoi **Murat Hoxha** i cili shfaqti shqetësimin për kufijnjt e Kosovës dhe apeloj për syqeltësi në shtetin tonë rreth kufijve përkatësisht ngushtimit të tyre. Pas marrëveshjes kufitare me Maqedonin ku ka pasur totalisht një jotransparencë, vazhdoi, tani pason i njëjti procedurë me Malin e zi. Ai potencoi problemet kadastrale të cilat kërkojnë profesionalizëm, ndajë edhe njerëz profesionist në këto negociata, jo vetëm thjesht teknik si dhe të ketë transparencë rreth argumenteve. Duke marginalizuar ne themi hajt se lehtë është, kurse në anën tjetër është tepër e ndjeshme (mori shembullin e Kroacisë dhe Sllovenisë të cilat kishin disa vite me radhë negociata kufitare). Pasi që diskutoi edhe **Shaip Muja** i cili kërkoi informacione zyrtare lidhur me këtë çështje, Murat Hoxha tha se nuk është problemi vetëm tek politika por edhe te Ligjet tona kadastrale të cilat mundësojnë lëshimet, ndaj **Kryetari Fikrim Damka** sugjeroi në fillim të qershorit të ftohet zyrtari i agjencisë kadastrale për njoftime të nevojshme, bashkë me ministrin (ftesën edhe për ministrin e kërkoi **Shaip Muja**).

Problemet rreth prerjes së pyjeve

Lidhur me këtë problematikë, diskutimin e hapi **Lahi Brahimaj** i cili shprehu habin se si edhe në këtë kohë tani jodimërore prerësit e drunjëve nëpër pyje nuk pushojnë, përkundrazi (ai tha se do ti sjellë edhe fotot që i ka siguruar), ndërkaj policia në këto ankesa përgjigjet thjeshtë : nuk është punë e juaja. Për diskutim u lajmëruan **Salih Salihu, Shaip Muja dhe Fikrim Damka** nga diskutimet e të cilëve rezultuan probleme të ngjashme edhe me qumshtë dhe patate, ndaj komisioni vendosi për mbledhjen e radhës, në orën 10,00 nga gjysmë ore të paraqesin problemet

shoqata e qumshtorëve dhe kompania për patate, ndërkaq prej orës 11,00 të ftohet kryeshefi i agjencisë së pyjeve.

Mbledhja do të mbahet të mërkurën në orën 10,00.

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Fikrim Damka